

LIGJI Nr. 05/L -062

PËR SIGURI NË PUNË NË VEPRIMTARINË MINERARE

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të Nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR SIGURI NË PUNË NË VEPRIMTARINË MINERARE

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i këtij ligji është që të përcaktojë parimet e përgjithshme për parandalimin e rreziqeve në punë dhe mbrojtjen e shëndetit të punonjësve në sektorin minerar, detyrimet e punëdhënësit, të drejtat dhe detyrimet e punëtorëve dhe personave përgjegjës për sigurinë në punë dhe shëndetin e punonjësve, të vendosë standardet e domosdoshme për sigurinë në punë në aktivitetet minerare. Me këtë ligj synohet përmirësimi sistematik i sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve në punë, parandalimi i lëndimeve në punë, sëmundjeve profesionale dhe sëmundjeve tjera që ndërliken me punën e sektorit minerar.

2. Ky ligj është në përputhshmëri me Direktivën e Këshillit nr. 89/391 EEC e datës 12 qershor 1989 për futjen e masave për inkurajimin e përmirësimit të sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve në punë dhe Direktivën e Këshillit nr. 92/104 e datës 3 dhjetor 1992 mbi kërkesat minimale për përmirësimin e sigurisë dhe mbrojtjes shëndetësore të punëtorëve në industrinë minerare sipërfaqësore dhe nëntokësore (Direktiva e dymbëdhjetë individuale sipas nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/EEC).

Neni 2

Fushëveprimi

1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen në sektorin minerar nga të gjitha subjektet e licencuara që ushtrojnë aktivitet minerar, si hulumtimi, shfrytëzimi dhe pasurimi i lëndëve të para minerale në Republikën e Kosovës.

Neni 3

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **KPMM** - Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale;

1.2. **Inspektorati i Minierave** - Departament në kuadër të KPMM-së, i cili ushtron funksionet dhe kompetencat në pajtim me Ligjin për miniera dhe minerale;

- 1.3. **Aksident në punë ose për shkak të punës** - ngjarje e papritur gjatë procesit të punës që shkakton dëmtim trupor të individëve, si invaliditet të përkohshëm apo të përhershëm ose që sjell vdekje, si dhe çdo dëmtim tjetër në shëndet që ka të bëjë me punën dhe ushtrimin e punës;
- 1.4. **Avari** - prishje e papritur e një makine, e një mekanizmi, pajisjeje, stabilimenti apo procesi teknologjik gjatë kohës së punës ose gjatë lëvizjes;
- 1.5. **Ekipet shpëtuese** - janë specialistët e minierës të certifikuar për shpëtim;
- 1.6. **Incident** - ndodhi e papritur, zakonisht e padeshifrueshme që pengon punën ose që dëmton gjendjen dhe ecurinë e rregullt të punës;
- 1.7. **Inspektor** - punonjësi i kualifikuar i KPMM-së që ushtron kontroll në veprimtarinë minerare në zbatim të këtij Ligji;
- 1.8. **Ndërmarrje** - subjekti i regjistruar sipas Ligjit për shoqëritë tregtare dhe i pajisur me licencë për hulumtim, shfrytëzim apo i licencuar për hulumtim dhe shfrytëzim të aktiviteve minerare nga KPMM-ja, në përputhje me Ligjin për miniera dhe minerale;
- 1.9. **Mbetje minerale** – mbetjet e materialit pas përfundimit të një faze të caktuar të një procesi industrial;
- 1.10. **Mbrojtja e jetës së punëtorëve** - qëllimi i mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të punëtorëve nga lëndimet në punë dhe nga sëmundjet profesionale, parandalimi i shkaqeve të lëndimeve e dëmtimeve të shëndetit në punë dhe krijimi i kushteve sa më të mira të punës në ndërmarrje;
- 1.11. **Mbrojtja në punë** - masat preventive, të përgjithshme dhe të posaçme, që janë me ndikim në krijimin e kushteve të sigurta të punës, posaçërisht për caktimin e të drejtave dhe obligimeve të punëtorëve, për shkak të shkeljes eventuale të detyrimeve të mbrojtjes në punë, organizimi i punëve të mbrojtjes në punë, detyrat e organeve të qeverisjes, procedurat e aprovimit të planeve dhe programeve për mbrojtje në punë, vendet e punës me kushte të posaçme, aftësimi i punëtorëve për mbrojtje në punë;
- 1.12. **Minierë** – sipas përkufizimit me Ligjin për miniera dhe minerale;
- 1.13. **Sanim** - angazhimi i aktiviteve që duhet marrë në hapësirat minerare me qëllim të përmirësimit të hapësirave të degraduara me punime minerare e në harmoni me projektin minierar;
- 1.14. **Resurset minerale** - sipas definimit me Ligjin për Miniera dhe Minerale;
- 1.15. **Shfaqja e rrezikut** - çdo shfaqje e papritur në procesin e shfrytëzimit të resurseve minerale dhe aktiviteve tjera, të cilat rrezikojnë jetën dhe shëndetin e punëtorëve, pasurinë dhe mjedisin;
- 1.16. **Shpëtuesi** - anëtar i çetës së shpëtimit, i certifikuar;
- 1.17. **Veprimtari minerare** - tërësinë e veprimeve që kryhen në nëntokë dhe në sipërfaqe

me qëllim të hulumtimit, zbulimit, shfrytëzimit dhe përpunimit të mineraleve;

1.18. **Atmosferë shpërthyesë** - përzjerje e ajrit me gaz, avuj, mjegull apo pluhur të ndezshëm, kur për shkak të kushteve atmosferike, pas ndezjes fillestare, procesi i djegies ka mundësi të bartet në tërë hapësirën, dhe të paraqesë burim potencial për shpërthim ose zjarre në vendin e punës, dhe mund të shkaktojë lëndime të punonjësve dhe dëmtime materiale;

1.19. **Punë me kushte të veçanta të punës** - punë të cilat për realizimin e tyre, punonjësi duhet t'i plotësojë kushtet e përgjithshme për punësim dhe kushtet e veçanta të cilat lidhen me moshën, kualifikimet profesionale, gjendjen shëndetësore dhe aftësitë psikike;

1.20. **Parandalimi** - masat e planifikuara apo të ndërmarra në çdo veprim punues të punëdhënësit, me qëllim të parandalimit ose reduktimit të rrezikut në punë;

1.21. **Sëmundje profesionale** - çdo sëmundje e shkaktuar si pasojë e ekspozimit nga elemente të dëmshme dhe të rrezikshme fizike, kimike, biologjike në ambientin e punës gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës;

1.22. **Dokumenti për vlerësim dhe parandalim të rrezikshmërisë** - dokumenti në të cilin përshkruhen karakteristikat e procesit të punës, identifikimi dhe vlerësimi i burimit të rrezikut, përcaktimi se kush mund të rrezikohet, nga çfarë rrezikohet dhe si, vlerësimi i rrezikut për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe përcaktimi i masave të nevojshme dhe të domosdoshme që duhet të ndërmerren për të parandaluar dhe për të zhvilluar këto masa në pajtim me rivlerësimet që bëhen në mënyrë periodike;

1.23. **Ministria** – Ministria përgjegjëse për sektorin minerar.

2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë ligj, të cilat nuk janë të përfshira në këto përkufizime, e kanë kuptimin e shprehjeve të përdorura në legjisllacionin në fuqi për minierat dhe mineralet dhe legjisllacionin tjetër në fuqi nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Neni 4

Detyrimet e përgjithshme të ndërmarrjes

1. Për të mbrojtur sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve, ndërmarrja merr masat e nevojshme për të siguruar që:

1.1. vendet e punës të projektohen, ndërtohen, pajisen, të vihen në veprim, të shfrytëzohen dhe të mirëmbahen në një mënyrë të tillë që punonjësit të mund ta kryejnë një punë të caktuar pa iu rrezikuar siguria dhe shëndeti i tyre;

1.2. vendet e punës ku janë të angazhuar të punësuarit, të jenë nën mbikëqyrje të personit përgjegjës;

1.3. puna e cila përfshin rreziqe të veçanta, i besohet vetëm personelit të kualifikuar i cili i kryen punët në përputhje me udhëzimet e dhëna;

1.4. pajisjet personale të mbrojtjes në punë;

- 1.5. të gjitha udhëzimet e sigurisë dhe shëndetit në punë, janë të kuptueshme për të gjithë të punësuarit;
 - 1.6. pajisjet e ndihmës së parë janë të siguruara;
 - 1.7. çdo trajnim dhe stërvitje përkatëse është kryer në intervale të rregullta.
2. Përveç dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni, punëdhënësi është i detyruar, që t'i ndërmarrë të gjitha masat parandaluese dhe mbrojtëse të përcaktuara në Ligjin në fuqi nr. 04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë.
3. Pa përjashtuar dispozitat e nenit 16 të Ligjit në fuqi nr. 04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë, dokumenti për vlerësimin e rrezikshmërisë në vendet e punës, duhet të përmbajë edhe:
- 3.1. përcaktimin dhe vlerësimin e rreziqeve të cilave u ekspozohen të punësuarit në vendin e punës;
 - 3.2. masat adekuate të cilat merren për të arritur sigurinë në miniera;
 - 3.3. projektimi, përdorimi dhe mirëmbajtja e vendit të punës dhe të pajisjeve, janë të sigurta.
4. Dokumenti për vlerësimin dhe parandalimin e rrezikshmërisë në vendin e punës, duhet të hartohet para fillimit të punës dhe të rishikohet nëse vendi i punës ka pësuar ndryshime të mëdha.

Neni 5

Dokumenti për vlerësim dhe parandalim të rrezikshmërisë në vendin e punës

1. Punëdhënësi duhet të përkujdeset që si masë sipas paragrafit 1 të nenit 4 të këtij ligji, të sigurojë dokumentin për vlerësim dhe parandalim të rrezikshmërisë në vendin e punës, para fillimit të punës. Në dokumentin për vlerësim dhe parandalim të rrezikshmërisë në vendin e punës, punëdhënësi duhet të marrë parasysh të gjitha rrethanat, kushtet e punës si dhe të gjitha masat e nevojshme, të cilat shërbejnë për siguri dhe mbrojtje shëndetësore të të punësuarve. Dokumenti për vlerësim dhe parandalim të rrezikshmërisë në vendin e punës duhet të jetë në dispozicion në ndërmarrje. Në këtë dokument duhet të përfshihen së paku, se:
 - 1.1. a janë hetuar rreziqet, të cilave u janë nënshtruar të punësuarit dhe grupet posaçërisht të rrezikuara të të punësuarve, në vendet e punës dhe punishtet përkatëse, a u janë nënshtruar vlerësimit dhe cilët janë rezultatet e vlerësimit të dhënë të rreziqeve;
 - 1.2. a janë marrë masa përkatëse teknike, organizative dhe personale për sigurinë dhe mbrojtjen shëndetësore të punësuarve;
 - 1.3. punishtet dhe pajisjet janë të rregulluara, të ushtruara dhe të mirëmbajtura në mënyrë të sigurt;
 - 1.4. të punësuarit njoftohen në mënyrë të përshtatshme për rreziqet për siguri dhe shëndet, si dhe për masat mbrojtëse dhe masat për parandalimin e rreziqeve në të gjitha

- punishtet përkatëse.
2. Gjatë vlerësimit të rreziqeve sipas paragrafit 1.1. të këtij neni duhet para së gjithash të merren parasysh ato rreziqe, që mund të dalin përmes:
 - 2.1. rregullimit dhe pajisjes së punishteve dhe të vendit të punës;
 - 2.2. rregullimit, përzgjedhjes dhe përdorimit të mjeteve të punës, sidomos të makinave, aparateve dhe pajisjeve, pastaj të lëndëve të punës, si dhe nga sjellja me mjetet e punës dhe me lëndët e punës;
 - 2.3. gjendjes së njohurive, vëllimit të përvojave dhe nga përshtatja fizike e të punësuarve.
 3. Punëdhënësi duhet ta rishikojë dhe plotësojë dokumentin për vlerësim dhe parandalim të rrezikshmërisë në vendin e punës sipas paragrafit 1 të këtij neni, në këto raste:
 - 3.1. nëse vendi i punës apo punishtet kanë pësuar ndryshime, zgjerime apo rirregullime të rëndësishme, ose;
 - 3.2. për të shmangur përsëritjen e ngjarjeve në ndërmarrje, të cilat ndërlidhen me nënparagrafët 1.1. dhe 1.2. të nenit 72 të Ligjit për miniera dhe minerale.
 4. Rezultati i verifikimeve të rregullta sipas paragrafit 2 të këtij neni, duhet të regjistrohet me shkrim në rast të masave të marra mbi bazën e dokumentit për vlerësim dhe parandalim të rrezikshmërisë në vendin e punës.

Neni 6

Masat teknike dhe të mbrojtjes në punë gjatë punimeve minerare

1. Gjatë realizimit të punimeve minerare të hulumtimit, hapjes, përgatitjes dhe të shfrytëzimit të lëndëve të para minerale, si dhe gjatë punimeve sipërfaqësore dhe nëntokësore, aplikohen masa mbrojtëse të caktuara me dispozitat ligjore të masave teknike dhe të masave të mbrojtjes në punë.
2. Objektet minerare dhe pajisjet tjera që shërbejnë për punëtorët duhet të jenë në gjendje sipas rregulloreve dhe dispozitave ligjore në fuqi dhe masave teknike të mbrojtjes në punë, gjatë zbatimit të punimeve sipërfaqësore dhe nëntokësore.
3. Në vendet e punës të rrezikuara nga ndikimi i pluhurit agresiv mineral, puna lejohet vetëm nëse prezenca e pluhurit agresiv në atmosferën e minierës nuk i tejkalon standardet e lejuara sipas dispozitave ligjore në fuqi. Ndërmarrja është e detyruar që së paku dy (2) herë në vit të kontrollojë çdo vend të punës në të cilën mund të lajmërohet pluhuri agresiv dhe të konstatohet shkalla e koncentrimit të tij në ambientin e minierës. Në vendet me rrezikshmëri të lartë, ndërmarrja është e obliguar që të bëjë kontrole të përhershme të prezencës së pluhurit agresiv dhe të konstatojë shkallën e koncentrimit të tij.
4. Punëtorët që zbatojnë operacione teknologjike gjatë ndërtimit të punimeve minerare në raste të ndërrimit të punishtes në të cilin më parë nuk kanë punuar, para fillimit të punës, personi përgjegjës duhet t'i njoftojë ata me rreziqet specifike në vendet e reja të punës dhe t'i njoftojë me masat teknike dhe masat e mbrojtjes në punë, të cilat kanë të bëjnë me vendin e ri të punës.

5. Hapësirat minerare në të cilat kryhen punë minerare ose që shërbejnë për kalim të njerëzve, informacioni dhe sinjalistika, ajrosja, transporti, hapësirat për largimin e ujërave, në kuptim të këtij Ligji duhet të jenë të mirëmbajtura dhe të siguruara sipas dispozitave në fuqi.

6. Çdo minierë duhet ta ketë planin e mbrojtjes dhe të shpëtimit nga rreziqet kolektive, të cilat mund të paraqiten në minierë. Me planin e mbrojtjes përcaktohen veprimet në rastet e paraqitjes së rreziqeve të ndryshme sipas dispozitave në fuqi.

Neni 7

Shërbimi i kërkim-shpëtimit, zjarfikësve dhe shërbimi i ndihmës së parë

1. Për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e punëtorëve, ndërmarrja ka për detyrë që:

1.1. të zbatojë me kohë të gjitha masat e mbrojtjes në punë, të përcaktuara me dispozitat e legjisllacionit në fuqi;

1.2. me akte të veçanta për mbrojtjen në punë, të rregullojnë funksionimin e mbrojtjes dhe masat e mbrojtjes në punë, në harmoni me organizimin e punës me veçoritë e rreziqet që mund të shfaqen;

1.3. të organizojë shërbimin e mbrojtjes në punë, t'u sigurojnë punëtorëve mjetet për mbrojtje personale, dhe mbrojtje kolektive;

1.4. të organizojë shërbimin për shpëtim dhe atë të ndihmës së parë, shërbimin e mbrojtjes nga zjarri, mbrojtjes nga uji dhe të mbrojtjes së ambientit të punës.

2. Ndërmarrja është e detyruar të organizojë shërbimin e mbrojtjes në punë, sipas kushteve specifike të tyre.

3. Shërbimin e mbrojtjes në punë e bën numri i nevojshëm i punëtorëve me përgatitje superiore ose të lartë profesionale.

4. Punët në kontrollin e drejtpërdrejtë të zbatimit të masave të mbrojtjes në punë mund t'i kryejnë edhe punëtorët me përgatitje të mesme profesionale, të cilët kanë së paku pesë (5) vjet përvojë pune në profesion.

5. Shërbimi i mbrojtjes në punë posaçërisht është i detyruar në zbatimin e masave të sigurisë në punë, duke përfshirë edukimin, përcjelljen e gjendjes shëndetësore dhe kontrolleve për punëtorët.

6. Për organizimin e shërbimit të mbrojtjes në punë dhe zbatimin e masave, si dhe për funksionimin e tij të rregullt e pa pengesa, përgjigjet menaxhmenti i ndërmarrjes.

7. Punët, respektivisht detyrat e punës në shërbimin e shpëtimit dhe të ndihmës së parë, si dhe në shërbimin e mbrojtjes nga zjarri, i kryejnë punëtorët, të cilët janë të certifikuar posaçërisht për këto punë.

8. Dy ose më shumë miniera, me marrëveshje mund të organizojnë shërbimin e përbashkët për shpëtim me ndihmë të parë, si dhe shërbimin për mbrojtje nga zjarri nëse natyra e punëve këtë e lejon.

9. Me akt të veçantë të ndërmarrjes, për mbrojtje në punë në nivel të ndërmarrjes përcaktohet:

- 9.1. mënyra e organizimit dhe e fushëveprimit të shërbimit të mbrojtjes në punë;
- 9.2. masat e përgjithshme të mbrojtjes në punë, me interes të përbashkët për tërë ndërmarrjen;
- 9.3. të drejtat dhe detyrimet e punëtorëve lidhur me aplikimin e masave mbrojtëse në punë.

10. Me qëllim të parandalimit të aksidenteve, incidenteve dhe prishjeve, ndërmarrja minerare është e detyruar t'i nxjerrë këto akte të brendshme si në vijim:

- 10.1. Rregulloren për sigurinë në punë, për shëndetin dhe për mjedisin e punës;
- 10.2. Rregulloren për planet emergjente, për funksionalizim të emergjencave dhe për mbrojtje nga zjarri;
- 10.3. Rregullore për transport vertikal dhe horizontal në minierat nëntokësore;
- 10.4. Rregullore për përdorim të makinave, të cilat përdorin motor me djegie të brendshme;
- 10.5. Rregullore për aftësimin e të punësuarve për punë të sigurta;
- 10.6. Rregullore për përdorim të pajisjeve personale mbrojtëse (PPM) në punë;
- 10.7. Rregullore për vlerësim të rrezikshmërisë së vendeve të punës me rrezikshmëri të shtuar;
- 10.8. Planin për mbrojtje nga ujërat.

11. Menaxhmenti i ndërmarrjes ka për detyrë që së paku çdo tre (3) muaj të shqyrtojë gjendjen e mbrojtjes në punë; punën e shërbimit të mbrojtjes në punë; të shërbimit të shpëtimit dhe të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri; dhe të caktojë masat që duhet aplikuar me qëllim të përmirësimit dhe përsosjes së mbrojtjes në punë.

12. Organi udhëheqës i ndërmarrjes ka për detyrë të shqyrtojë konstatimin e inspektoratit të minierave me rastin e kontrollit të rregullt dhe atij pa paralajmërim dhe për masat e marra të njoftojë me shkrim KPMM-në dhe organin kompetent për punët e inspektoratit të minierave.

Neni 8

Veprimet në rastin e shfaqjes së rreziqeve të papritura

1. Ndërmarrja minerare është e detyruar që sipas rrethanave të saj specifike, të përcaktuara me rregullore dhe sipas kushteve që mbizotërojnë, të organizojë shërbimin e shpëtimit dhe shërbimin e zjarrfikësve, në rast të shfaqjes së rreziqeve të papritura.

2. Punët e shërbimit të shpëtimit dhe të shërbimit të zjarrfikësve i kryejnë punëtorët të cilët janë të certifikuar.

3. Detyrimet e shërbimit të shpëtimit dhe shërbimit të zjarrfikësve janë:

3.1. që menjëherë t'iu dalë në ndihmë punëtorëve, të cilët gjenden në rrezik, në raste të shpërthimit të metanit, pluhurit të qymyrit, zjarrit në miniera, si dhe rreziqeve të tjera në minierë;

3.2. të krijojë qarkullim pa pengesë dhe mundësi të kryerjes së punëve të detyruara në hapësirat minerare ku ka prani të gazrave helmuese;

3.3. që në thirrje të ndërmarrjes minerare tjetër, të dalë në ndihmë me të gjitha mjetet që i ka në dispozicion.

Neni 9

Punëtorët me autorizime dhe përgjegjësi të posaçme në kryerjen e punëve teknike profesionale, në fushën e mbrojtjes në punë dhe shëndetit të punëtorëve

1. Punët minerare gjatë kërkimit dhe shfrytëzimit të lëndëve të para minerale, në fushën e mbrojtjes në punë dhe shëndetit të punëtorëve, mund t'i kryejnë vetëm punëtorët, të cilët i plotësojnë kushtet e përcaktuara sipas dispozitave të këtij Ligji.

2. Punët e mbikëqyrësit në minierë mund t'i kryej punëtori, i cili ka të kryer përgatitjen e mesme profesionale të drejtimit përkatës, të ketë së paku pesë (5) vjet përvojë pune dhe të jetë i licencuar për siguri në veprimtarinë minerare.

3. Punët e kryepunëtorit në minierë mund t'i kryej inxhinieri, i cili ka të kryer nivelin bachelor të drejtimit përkatës, të ketë së paku dy (2) vjet përvojë pune, të jetë i licencuar për siguri në veprimtarinë minerare.

4. Punët e udhëheqjes teknike në miniera nëntokësore mund t'i kryej punëtori i cili ka të kryer fakultetin përkatës teknik me nivel master; të ketë më së paku tre (3) vjet përvojë pune dhe të jetë i licencuar për siguri në veprimtarinë minerare.

Neni 10

Detyrimet për marrjen e masave

1. Ndërmarrja është përgjegjëse për organizimin e shërbimit për siguri në punë, për mbrojtje kundër zjarrit dhe për kërkim-shpëtim.

2. Për zbatimin e masave të mbrojtjes në punë, përgjegjës janë të gjithë të punësuarit në ndërmarrje, në kuadër të fushëveprimit të tyre të punës në pajtim me rregullat dhe masat e mbrojtjes në punë.

3. Ndërmarrja është e detyruar që çdo muaj të raportojë me shkrim në Inspektoratin e Minierave, për numrin e rasteve të aksidenteve të raportuara, si dhe për aksidentet me invaliditet të përkohshëm apo të përhershëm, si dhe për analizën e kostos së shpenzimeve financiare të krijuara si pasojë e aksidenteve në punë.

Neni 11**Informimi i të punësuarit për rregulloret**

1. I punësuarit që themelon marrëdhënie pune në një ndërmarrje, para së të caktohet në një vend pune duhet të informohet për zbatimin e rregulloreve dhe masave të mbrojtjes në punë dhe masave për mbrojtje nga zjarri, me rreziqet që mund të hasen në punë, si dhe me organizimin dhe zbatimin e masave mbrojtëse në punë në kuadër të ndërmarrjes.
2. I punësuarit ka të drejtë të kërkojë nga personat përgjegjës për zbatimin e rregulloreve, që të informohet me rreziqet e punës, me ligjet dhe detyrimet në lidhje me mbrojtjen në punë dhe me kushtet e punës.

Neni 12**E drejta në informim në rast të ndërrimit të vendit të punës**

I punësuarit i cili caktohet në një detyrë ose vend tjetër të punës, para fillimit të punës duhet të njoftohet me punën, rregullat dhe masat e mbrojtjes në punë, si dhe me rreziqet të cilat mund të ndodhin në këto punë e detyra të reja.

Neni 13**Organet përgjegjëse për inspektim**

1. Inspektorati i Minierave përveç autorizimeve që ka me Ligjin për Miniera dhe Minerale, është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji.
2. Inspektorati i Minierave është i autorizuar të urdhërojë që:
 - 2.1. parregullsitë dhe mangësitë e vërtetuara të eliminohen në afatet të cilat i përcakton inspektori;
 - 2.2. të ndalojë punën në objektin mineral ose kryerjen e disa aktiviteteve të caktuara nëse në afatin e caktuar nuk janë eliminuar mangësitë dhe parregullsitë e vërtetuara.
3. Përveç marrjes së masave nga paragrafi 2. i këtij neni, inspektori është i autorizuar edhe :
 - 3.1. të përcaktojë masat e sigurisë në rast rreziku për jetën, shëndetin e njerëzve dhe ambientin e punës;
 - 3.2. të parashtrijë fletëparaqitje tek organi kompetent për veprë penale, dhe të iniciojë procedurë gjyqësore;
 - 3.3. të njoftojë organet tjera nëse ekzistojnë arsye për ndërmarrjen e masave për të cilat ai organ është përgjegjës.
4. Ndërmarrja minerare, të cilës në bazë të vendimit të inspektorit i është urdhëruar që t'i eliminojë parregullsitë në pajtim me këtë nen, është e detyruar që të lajmërojë Inspektoratin e Minierave në afat prej tetë (8) ditësh nga data e zbatimit të vendimit të Inspektoratit, se janë eliminuar të gjitha parregullsitë e evidencuara me vendim të inspektorit.

5. Ndërmarrja minerare është e detyruar që të informojë Inspektoratin e Minierave për të gjitha rastet e fatkeqësive, aksidenteve apo lëndimeve të rënda në punë dhe ta pezullojë aktivitetin minerar aty ku ka ndodhur lëndimi apo prishja dhe të lajmërohet inspektori më së largu brenda dymbëdhjetë (12) orësh për ditë të punës dhe njëzetekatër (24) orësh për ditë vikendi apo ditë festash shtetërore.

6. Inspektorati i Minierave është i detyruar që menjëherë t'i përgjigjet lajmërimit për raste të fatkeqësive me fatalitet, si dhe rasteve të aksidenteve tjera. Në vend të ngjarjes të hulumtojë shkaqet dhe burimin e fatkeqësisë, aksidentit apo prishjes aksidentale dhe me këtë rast të hartojë raport me shkrim, me të cilin informon organet përgjegjëse në afat sa më të shkurtër.

7. Inspektorati i Minierave është i detyruar të kryejë vizitën inspektuese të punimeve minerare dhe objekteve më së paku njëherë (1) në vit, ndërsa për objektet minerare të rrezikuara nga metani dhe pluhuri i rrezikshëm i qymyrit të bëhen vizita konform Ligjit në fuqi për miniera dhe minerale.

8. Pa përjashtuar paragrafin 7 të këtij neni, Inspektorati i Minierave mund të bëjë vizita inspektuese edhe pa paralajmërim.

9. Ndërmarrja është e detyruar t'i mundësojë inspektorit hyrjen në hapësirat punuese, marrjen e mostrave të burimeve minerare dhe materialit punues, më qëllim të hulumtimit dhe sigurimit të provave.

Neni 14 **E drejta për ankesë**

1. Kundër vendimit të Inspektoratit të Minierave, ndërmarrja mund t'i drejtohet me ankesë Bordit të KPMM-së në afat prej tetë (8) ditësh nga pranimi i vendimit.

2. Ankesa e paraqitur kundër vendimit të Inspektoratit të Minierave nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit.

Neni 15 **Gjobat**

1. Me gjobë prej pesëmijë (5000) deri në dhjetëmijë (10.000) euro do të ndëshkohet ndërmarrja dhe persona tjerë juridik në rast se:

1.1. nuk u përmbahen masave të rregulluara të mbrojtjes në punë dhe masave të sigurisë së njerëzve dhe të pasurisë;

1.2. në bazë të matjeve nuk i hartojnë ose nuk i plotësojnë planet në bazë të të cilave mund të vërtetohet gjendja e punimeve minerare dhe gjendja e tyre reciproke, si dhe nuk e pasqyrojnë gjendjen në lidhje me aktivitetet e vjetra minerare dhe të objekteve dhe ujërave në sipërfaqe; nuk posedojnë planin afatgjatë, përkatësisht një plan operativ vjetor, ose nëse ato plane ose kopje të planeve dhe sipas kërkesës nuk i paraqesin ose nuk i mbajnë librat matëse dhe librat e mbikëqyrjes minerare;

1.3. kryejnë punët në hartimin e dokumentacionit teknik dhe nuk i plotëson kushtet e përshkruara me këtë ligj;

1.4. në kryerjen e punëve minerare dhe punëve tjera para vendosjes së pajisjeve, dalin nga projektet e miratuara pa marrëveshje me organin kompetent;

1.5. pas përfundimit ose ndërprerjes së përhershme të aktiviteteve në eksploitim minierar, nuk e lajmëron ministrinë përkatëse në afatin e paraparë, si dhe Inspektoratin e Minierave, dhe inspektorin e mjedisit për masat e sigurisë, sanimit dhe rikultivimit;

1.6. vërtetuesit e hartimeve të dokumentacioneve teknike ose revizionin e projekteve ose kryerjen e kontrollimeve periodike, matjeve dhe testimin ose kryerjen e punëve minerare të ndërmarrjes, ose ndonjë personi tjetër juridik, nuk i përmbushin kushtet e përshkruar në këtë ligj;

1.7. nëse pas përfundimit ose pezullimit të përhershëm të aktiviteteve minerare, në bazë të afateve të miratuara në projekt nuk e bëjnë sanimin përfundimtar të degradimit të tokës dhe rikultivimin e hapësirave në rrethinën e dëmtuar si pasojë e aktivitetit minierar, dhe nuk kanë ndërmarrë masat e duhura për mbrojtjen e jetëve të njerëzve dhe pasurisë;

1.8. nëse nuk posedojnë dokumentacionin teknik;

1.9. nëse nuk e kanë të organizuar shërbimin e mbrojtjes në punë;

1.10. nëse nuk e lajmërojnë me kohë Inspektoratin e Minierave dhe organet kompetente për çdo rast vdekjeje, lëndime kolektive a lëndime të rënda në punë;

1.11. në afatet e caktuara nuk lajmërojnë ministrinë përkatëse dhe Inspektoratin e Minierave për çdo ndërprerje të përkohshme të punimeve minerare ose shfaqjen e çdo rreziku për jetën e njerëzve dhe shëndetin e punëtorëve ose rifillimin e punimeve minerare;

1.12. nuk sigurojnë kryerjen e punimeve minerare sipas dokumentacionit teknik dhe rregulloreve, si dhe nuk sigurojnë mbikëqyrje të përhershme të të gjitha punimeve, pajisjeve dhe stabilimenteve minerare;

1.13. në punët e mbikëqyrjes dhe udhëheqjes teknike caktojnë persona të cilët nuk i përmbushin kushtet e përcaktuara;

1.14. ndërmarrja minerare nuk i siguron pajisjet personale mbrojtëse, si dhe pajisjet tjera për siguri në punë, për mbrojtje nga zjarri dhe për kërkim shpëtim.

Neni 16

Aktet nënligjore

1. Ministria pas propozimit të KPMM-së, në afat prej gjashtë (6) muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, nxjerr këto akte nënligjore si në vijim:

1.1. Rregulloren për udhëheqjen e evidencave dhe ruajtjen e dokumenteve, si dhe për përmbajtjen e raporteve vjetore nga fusha e mbrojtjes së aktiviteteve minerare në punë;

1.2. Rregulloren për masat dhe normat e mbrojtjes në punë, për përdorim të pajisjeve

dhe veglave të punës;

1.3. Rregulloren për përbërjen, detyrat dhe përgjegjësitë e ekipit të shpëtimit;

1.4. Rregulloren për formën e raportit të aksidenteve në punë në miniera.

2. Ministria përkatëse për punë të brendshme, pas propozimit të KPMM-së, në afat prej gjashtë (6) muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, nxjerr Rregulloren për masat mbrojtëse dhe normat teknike gjatë përdorimit të materieve eksplozive dhe minimit në miniera.

3. Ministria përkatëse për punë dhe mirëqenie sociale, pas propozimit të KPMM-së, në afat prej gjashtë (6) muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, nxjerr Rregulloren për përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësive bazë, të shërbimit të mbrojtjes në punë për aktivitete minerare.

Neni 17 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 05/L -062
10 mars 2016

Shpallur me dekretin Nr. DL-006-2016, datë 29.03.2016 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga